



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2018/2019

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

1. Kali dhe Gomari

Një njeri kishte një kalë dhe një gomar. Kur njëherë ishin duke udhëtuar, gomari i tha kalit:

- Merr pak prej barrës sime, të lutem, që të mbetem gjallë. Kali nuk e dëgjoi. Kështu gomari, nga lodhja e tepërt, u rrëzua dhe ngordhi.

I zoti, mandej, ja ngarkoi tërë barrën kalit, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

Kali filloi të ankohej:

- Oh unë i mjeri, ç'ka më gjeti! Nuk dëgjova që të mbartja barrë të vogël, kurse tash, ja po i mbart të gjitha, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

Kali u tregua:

a) I pasjellshëm;

b) Mendjemadh;

c) Torollak (i marrë).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

2. Kali dhe Gomari

Një njeri kishte një kalë dhe një gomar. Kur njëherë ishin duke udhëtuar, gomari i tha kalit:

- Merr pak prej barrës sime, të lutem, që të mbetem gjallë.

Kali nuk e dëgjoi. Kështu gomari, nga lodhja e tepërt, u rrëzua dhe ngordhi. I zoti, mandej, ja ngarkoi tërë barrën kalit, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

Kali filloi të ankohej:

- Oh unë i mjeri, ç'ka më gjeti! Nuk dëgjova që të mbartja barrë të vogël, kurse tash, ja po i mbart të gjitha, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

Lexo tekstin e lartshënuar me kujdes dhe jep përgjigjen e saktë para pyetjes.

a) A e dëgjoi kali lutjen e gomarit? _____

b) Ç`ndodhi me gomarin? _____

c) Po me kalin ç`ndodhi? _____

3. I. Kali dhe Gomari

Një njeri kishte një kalë dhe një gomar. Kur njëherë ishin duke udhëtuar, gomari i tha kalit:

- Merr pak prej barrës sime, të lutem, që të mbetem gjallë.

Kali nuk e dëgjoi. Kështu gomari, nga lodhja e tepërt, u rrëzua dhe ngordhi. I zoti, mandej, ja ngarkoi tërë barrën kalit, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

Kali filloi të ankohej:

- Oh unë i mjeri, ç'ka më gjeti! Nuk dëgjova që të mbartja barrë të vogël, kurse tash, ja po i mbart të gjitha, madje edhe lëkurën e gomarit të ngordhur.

II. Atdheu

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka

Më je nënë, më je motër, më je vlla.

Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,

Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.

Ty përditë të pat parë ime nënë,

Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.

Nëmëruar t'i pat lulet syri i saj.

Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.

Ti i ke parë gjysh stërgjyshërit e mi,

Edhe eshtërat tretur ua ke po ti.

Nga ti, o shpirt-o kurrë s'qenë ndarë.

Pranë teje patën qeshur, patën qarë.

Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,

Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë,

Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.

Begatoje, o Zot, ti këtë vend!

Tekstet e lartshënuar janë:

Teksti I. është: _____;

Teksti II. është: _____.



4. Në vizat e dhëna shkruaj klasat e fjalëve që janë pjesë të ndryshueshme.

1. _____;

2. _____;

3. _____;

4. _____;

5. _____;

Trego përse janë të ndryshueshme:



5. Gjej dhe nënvizo fjalët e shkruara gabimisht, të cilat janë të dhëna mëposhtë.

Buzqeshur, jashtëshkollor, drithije, flokëgështenjë, bojgështenjë etj.

6. Shkruaj drejt fjalët e poshtëshënuara.

cop copë _____; duar duar _____; fije fije _____;
ham ham _____; hyrje dalje _____; aty këtu _____.

7. Fjalët e dhënë ndaji në dy shtylla, në fjalë të ndryshueshme dhe në fjalë të pandryshueshme:
maskë, atje, lojë, me, muzikor, por, i urtë, jo, ata, uh, ynë, ah, tre, shtatë, mirë, lexoj, sot, thërras.

Të ndryshueshme	Të pandryshueshme

8. Lidh fjalët sipas klasave. Lidhi sipas modelit, për shembull **Syze – emër**, dhe lidh me shigjetë shembujt në vazhdim. Ndiq shembullin e dhënë.

fitore

Fjala	Klasa
syze	Ndajfolje
I artë	Parafjalë
Atje	Folje
Tek	Mbiemër
Kërkoj	Emër

9. Fjalët:dritë, larg, bukë, krye, zjarr, sy, vend janë:

a) Fjalë të parme.

b) Fjalë të përbëra;

c) Fjalë të prejardhura.

Rretho përgjigjen e saktë.

10. Klasifiko fjalët e dhënë në kllapa:

(ore, edhe, vëzhgoj, dëshirë, i tmerrshëm, mos, me, kësaj, shpejt, tre etj.)

Emër _____

Mbiemër _____

Përemër _____

Numëror _____

Folje _____

Ndajfolje _____

Parafjalë _____

Lidhëz _____

Pjesëz _____

Pasthirmë _____

11. Bashkëtingëlloret e poshtëshënuara *p, b, v, p, m* janë:

a) *Qiellzore;*

b) *Dhëmbore;*

c) *Buzore.*

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

12. Në fjalitë e dhëna, fjalët e nënvizuara janë rrethanorë.
Shkruaj më poshtë llojin e tyre.

1. Ky fshat ndodhej matanë maleve.
2. Nuk do ta ulë kokën kurrë përpara tyre.
3. Pemët u rrëzuan nga era.
4. Djemtë shkonin në pyll për dru.
5. Punonte me pasionin më të madh.
6. Mendo shtatë herë dhe fol një herë.

1. Rrethanor _____
2. Rrethanor _____
3. Rrethanor _____
4. Rrethanor _____
5. Rrethanor _____
6. Rrethanor _____

13. Emrat *qytete dhe dete* janë dhënë në variante të ndryshme në numrin shumës. Tregoni variantin e saktë:

- a) qytete të mëdha;
- b) qytete të mëdhenj;
- c) dete të thella;
- ç) dete të thellë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

14. Grupi emëror është gjymtyrë kryesore i fjalisë së thjeshtë dhe përbëhet nga:

- a) kryefjala dhe përcaktori;
- b) kryefjala dhe rrethanor;
- c) kundrinori dhe përcaktori;
- ç) kallëzuesi dhe përcaktori.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- 15.** Ish Harapi, po, ‘i trim me nâm,
 zullum bájke horri n’katër anë,
 shih, bezar, po, dynjënë qi pë bâ
 – Gjithë ku i gjêjke ai trimat me nâm,
 t’tanë Harapi po m’i thrret n’mejdán
 e si zâna horri po i shiton;
 gjithë ku ishin zigjinat me mall,
 mallin plaçkë ai horri tu’ jau marrë;
 gjithë ku ishin çikat për martesë
 me ka ‘i natë ai çikninë po jau merr.
 Bájke nâm e bájke, po, beter,
 t’tana ylqet mretit po ja shkel, s
 hkelke ylqet e po bân çudi.
 (I) ka ardhë koha për me dalë n’Shqipni.

Lexo Vargjet e dhëna dhe nga kuptimi i këtyre vargjeve këto këngë quhen:

a) Këngë _____

b) I përkasin letërsisë _____

- 16.** Lexo me vëmendje vargjet e dhëna dhe trego cilit lloj të letërsisë i përkasin?

Oú, më pa: tho:n, ehe, po i çu:d-e t’vogël, o he!
 O, n’natje â çua, he, Çeto Bash-e Muji,
 E, po e ka dhe:z-e zjarmin-e n’oxhak,
 Ehe, o, po pi-e Muji kafe me shiçer,
 Eje, o, po n’çef-e, he, trimi, o, â bâ:;
 Ani, o, po i ka ma:rr, he, ibrik e legen,
 Eje, o, avdes t’bâ:rdh, more, po, Muji-e po merr,
 Eje, o, po e ka fa:l-e sabah dritn-e bâ:rdh.
 Eje, o, kur sabahin, he, Muji e baroi,
 Eje, o, nâna e vet-e, po, nò:d, he, m’â shkua,
 Eje, po kîêka û:xh-e n’krevetin tu dera,
 Ani, e dorën n’façe, he, nâna-e pë vno.
 E, a ç’ka bâ-e Çeto Bash-e Muji:
 Ani, po, i-o kafe nâ:ns-e po ja ço,
 Eje, a po do-e kafen me ja dhâ:n,
 Eje, o çka bâ-e nâna, por, e Mujit,
 Eje, dorën grusht-e, he, nâna-e pë bâ,
 Eje, o, po n’filxhan, eje, Mujit-e i ka ra:;
 Eje, po, çat kafe, he, mi:r po ja de:rdh.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) *letërsi e artistike(të shkruar);*

b) *letërsi popullore;*

17. Flokarta dhe tre arinjte

Na ishte njëherë një vajzë, që kishte një emër të bukur, Flokartë. Një ditë, megjithëse nëna ia kishte ndaluar, Flokarta u largua nga shtëpia dhe shkoi në pyll për të mbledhur lule të egra. Ajo nuk e vuri re diskun e kuq të diellit që fundosej pak nga pak përtej maleve. Shpejt ra nata dhe e errësoi pyllin. Për një kohë të gjatë Flokarta u end pyllit, duke qarë me dënësë sepse nuk po gjente rrugën për në shtëpi. Meqë u lodh, ajo u ul rrëzë një lisi. Po në atë kohë u duk së largu një dritë që shkëlqente: atëherë Flokarta mori guximin dhe eci drejt saj. Më në fund mbërriti para një shtëpie të vogël, të cilën s'kishte parë kurrë ndonjëherë dhe mu aty mendoi të kërkonte strehim.

Por Flokarta nuk e dinte që kjo shtëpi banohej nga një familje prej tre arinjsh: baba ariu, nëna arushë dhe arushi i vogël, bebë. Në kuzhinë ndodhej një tryezë dhe pranë saj ishin tri karriga: e para ishte e madha, e dyta mesatare dhe e treta më e vogël.

Të tre arinjtë kishin shkuar për të bredhur dhe, para se të iknin, nënë arusha kishte bërë gati supën dhe e kishte hedhur në tre çanakë. Çanaku i parë ishte i madh, i dyti me madhësi mesatare dhe i treti fare i vogël dhe i bukur. Flokarta vështroi nga dritarja dhe, meqë kishte shumë uri, ushqimi që ishte hedhur nëpër çanakë iu duk joshës: ajo shtyu derën dhe hyri brenda.

- Sa mirë qenka! - tha ajo.

Dhe u ul në karrigën e madhe, por kjo ishte tepër e madhe për të. Provoi karrigen mesatare, por ajo nuk arrinte gjer në tryezë. Atëherë Flokarta u ul në karrigen e vogël, që i rrinte për bukuri. Mori çanakun dhe e përplau shpejt e shpejt supën e arushës së vogël. Kur e mbaroi, e ndjeu veten të lodhur. Dhe mendoi se do të ishte mirë të shtrihej. Hipi, pra, në shkallë dhe u fut në dhomën që kishte tre shtretër. I pari ishte i madh, i dyti mesatar dhe i treti një shtrat i bukur, fare i vogël. Ajo provoi në fillim të madhin, por ky ishte tepër i madh. U ngrit e provoi të dytin, por edhe ai, gjithashtu ishte tepër i madh. Atëherë u shtri në shtratin e vogël dhe fjeti me grushtet shtrënguar pranë fytyrës.

Arinjtë u kthyen shpejt. Meqë të bredhurit ua kishte shtuar oreksin, ata shkuan menjëherë për të ngrënë në tryezë.

- Dikush është ulur në karrigën time! - bërtiti baba ariu, me zërin e vet kumbues e të trashë.

- Dikush është ulur në karrigën time! - bërtiti nënë arusha, me trupin mesatar dhe zërin jo të fortë.

- Dikush është ulur në karrigën time! - bërtiti arusha e vogël me zë të hollë.

Pastaj ata hodhën sytë në çanakun e tyre.

- Dikush e ka provuar supën time! - bërtiti baba ariu.

- Dikush e ka provuar supën time! - bërtiti nënë arusha.

- Dikush e ka provuar supën time dhe e ka ngrënë atë! - bërtiti me të madhe edhe arushi i vogël me zërin e hollë.

- Cili mund të ketë qenë vallë? - bërtitën njëherësh të tre arinjtë.

Baba ariu vrapoi për të shtrati i vet.

- Dikush është shtrirë në shtratin tim! - briti përsëri ai.

Nënë arusha vrapoi te shtrati mesatar.

- Dikush është shtrirë në shtratin tim! - u dëgjua edhe zëri i saj jo fort i trashë.

Ndërkohë edhe arushi i vogël bërtiti me sa fuqi që kishte:

- Dikush është shtrirë në shtratin tim! Ah, ja tek është!

Po në atë kohë Flokarta u zgjua dhe i pa të tre arinjtë, që po e vështronin me inat. Ajo u llahtarisi aq shumë sa kërceu nga shtrati, zbriti shkallët me shpejtësi sa nuk ia kishte marrë kurrë mendja dha shpëtoi, duke u futur në pyll. Të nesërmen Flokarta u takua me një druvar, i cili me sëpatën në krah shkonte për të bërë dru dhe i tregoi atij ç'i kishte ndodhur. Meqë ai e njihte pyllin si në pëllëmbë të dorës, e përcolli vajzën gjer në fshat. Prindërit e pritën Flokartën me lot gëzimi. Pas kësaj, vajza me flokë të artë u bë fëmijë i bindur dhe nuk u largua kurrë më vetëm nga shtëpia.

Lexo tekstin e mësipërm dhe nënvizo llojin e këtij shkrimi.

a) përrallë; b) legjendë; c) mit; ç) tregim historik.



18. Lexo vargjet e mëposhtme.

Merrjau bukën se e harrojnë djathin

Ni zot shpije, kur shkoj tu shpija, po i nie tuj kajtë thminë.

E thrret t' shoqen e i thot:

- Oj grue, çka kanë thmija qi po kajnë?
- U kam dhanë bukë e tash po lypin edhe djath.
- Merrjau bukën se e harrojnë djathin.

a) Cilës letërsi i përket ky tekst:

b) Si quhet ky lloj i tekstit:

19. Lexo poezinë dhe trego figurën letrare të cilën e hasim në këto vargje:

Mu në mes të gurëve

Lindi një re manushaqesh.

...

Trimi fjeti i helmuar

Në ëndërr pa derën e saj.

Rreto shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) alegorinë;
- b) metafora;
- c) Krahasimimit.

20. Udha e mbarë se erdh pranvera,
shko, dallëndyshe tue fluturue,
prej Misirit ndhena tjera,
fusha e male tue kërkue;

Lexo vargjet e mësipërme dhe trego llojin e vargut dhe rimës.

1. Lloji i vargut _____ dhe _____ rrokësh.

2. Rima e _____.